



Fundi i fazes se pare te kampionatit i ka dhene mundesi lojtareve te pushojne per pak dite. Me nderprerjen e aktivitetit, futbollistet e huaj pergjithesisht kane marre leje nga klubet e tyre dhe jane larguar per te pushuar e per te takuar familjet e tyre. Nje nga tre fazat e Kategorise Superiore perfundoi e tani do te zhvillohen edhe dy te tjera. Kampionati do te rinise ne daten 22 nentor me disa sfida delikate. Kete fundjave nuk do te kete futboll pasi Kombetarja Shqiptare luan nje miqesore me Bjellorusine ne Antalia. Klubet e Superiores do te periftojne per te punuar drejt misionit per tu permiresuar dhe pritet te luhen disa ndeshje miqesore qe vlejne per trajneret.